
Analizë e përmbajtjeve me bazë gjinore:



Qasja mediatike ndaj përdhunimit dhe pëlqimit

Analizë e përmbajtjeve me bazë gjinore:

Qasja mediatike ndaj përdhunimit dhe pëlqimit

Botues:

Instituti për Studime të Komunikimit
rr. “Jurij Gagarin” 17-1 / 1, Shkup
www.iks.edu.mk

Rreth botuesit:

prof. dr. ZanetaTrajkoska

Edicioni:

ResPublic

Autore:

mr. Bojana
Jovanovska mr. Sara

Redaktor:

mr. Dejan

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Vjosa Taipi

Titulli origjinal:

Анаиза на родово базирани содржини - Медиумскиот пристап кон силувањето и согласноста

Dizajn grafk:

Igor Dellov

Vendi dhe viti:

Shkup, 2025

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

364.63-055.2(497.7)(047.31)
343.541:316.774(047.31)
364.633-055.2:316.774(047.31)

JOVANOVSKA, Bojana
Analizë e përmbajtjeve me bazë gjinore [Електронски извор]. Qasja mediatike ndaj përdhunimit dhe pëlqimit / [autore Bojana Jovanovska, Sara Milenkovska ; përkthyer nga gjuha maqedonase Vjosa Taipi]. - Shkup : Instituti për Studime të Komunikimit, 2025. - (Едиција ResPublica)

Начин на пристапување (URL):
https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2025/05/qasja-mediatike-ndaj-perdhunimit-dhe-pelqimit.pdf.
- Превод на делото: Анализа на родово базирани содржини. Медиумскиот пристап кон силувањето и согласноста. - Текст во PDF формат, содржи 30 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 14.05.2025.
- Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4805-59-5

1. Milenkovska, Sara [автор]
а) Родово базирано насилство -- Македонија -- Истражувања б) Родово базирани содржини -- Силување -- Медиуми -- Истражувања

COBISS.MK-ID 65939461

Hyrje

Dhuna me bazë gjinore është një nga format më të rënda të shkeljeve të të drejtave të njeriut, me pasoja të thella individuale dhe sociale. Në këtë kontekst, mediat kanë një rol kyç për të luajtur si platformë për informim, edukim dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, duke mbajtur përgjegjësi të madhe në mënyrën se si raportojnë për rastet e dhunës me bazë gjinore. Mediat kanë fuqinë të formësojnë opinionin publik, të normalizojnë ose të thyejnë stereotipet gjinore dhe të kontribuojnë në krijimin e një shoqërie që njeh dhe lufton kundër formave të ndryshme të kësaj lloj dhune.

Raportimi joadekuat i rasteve të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht dhunës seksuale, mund të rezultojë në pasoja të rënda për viktimat, siç është viktimizimi i dyfishtë, si një proces në të cilin vëmendja e mediave traumatizon më tej dhe në mënyrë të përsëritur viktimën. Gjuha sensacionale, mosrespektimi i privatësisë dhe injorimi i standardeve etike kur raportohen raste të ndjeshme mund të shkaktojnë pasoja afatgjata psikologjike dhe shoqërore. Në vend që të jenë aleatë në luftën kundër dhunës, mediat shpesh bëhen pa dashje pjesë e problemit, duke ushqyer stereotipet dhe kulturën e tolerimit dhe normalizimit të dhunës.

Në këtë kontekst, roli i mediave në raportimin e rasteve të dhunës seksuale është thelbësor, pasi (pa)aftësia e tyre për të njohur, emëruar dhe kontekstualizuar dhunën ndikon drejtpërdrejt në perceptimin dhe qëndrimet e publikut ndaj këtij fenomeni. Njohja dhe emërtimi i qartë i dhunës, veçanërisht dhunës seksuale, është hapi i parë drejt krijimit të vetëdijes shoqërore dhe dënimit kolektiv të akteve të tilla. Nëse media nuk arrin të identifikojë dhe emërtojë në mënyrë adekuate këto fenomene, jo vetëm që mund të zbehë peshën e problemit, por gjithashtu të nxisë një kulturë të tolerancës dhe normalizimit, veçanërisht në hapësirën digjitale.

Në ditët e sotme, ndikimi i mediave shtrihet përtej platformave tradicionale, me rrjetet sociale duke u bërë një nga burimet kryesore të informimit për shumë qytetarë. Mënyra në të cilën mediat raportojnë për rastet e dhunës me bazë gjinore në hapësirën online ku përmbajtja po përhapet me shpejtësi, rrit rrezikun e

keqpërdorimit të tyre. Raportet gazetareske joetike dhe sensacionale mund të provokojnë lehtësisht reagime negative, të stigmatizojnë më tej viktimën ose të krijojnë diskutime në internet që do të rezultojnë në viktimizim ose urrejtje.

Nga ana tjetër, media përmes raportimit adekuat dhe të përgjegjshëm mund, por gjithashtu ka një detyrim ligjor për të punuar në edukimin dhe ngritjen e vetëdijes publike për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Kur mediat përmendin në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme dhunën seksuale, ato jo vetëm që mishërojnë rolin e tyre parandalues, por gjithashtu inkurajojnë qytetarët, veçanërisht komunitetin online, të njohin dhunën, të mbajnë qëndrim kundër saj dhe t'i mbajnë institucionet përgjegjëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e epokës digjitale, ku përmbajtja e krijuar nga media mund të nxisë ndryshime pozitive sociale, por vetëm nëse bazohet në standarde etike dhe profesionale.

Për të bërë një analizë të thelluar të ndikimit të raportimit të mediave në rastet e përdhunimit mbi vazhdimësinë e sterotipeve gjinore në shoqëri, Instituti i Studimeve të Komunikimit hartoi analizën "Qasja mediatike ndaj përdhunimit dhe pëlqimit".

Metodologjia

Duke analizuar gjuhën dhe përdorimin e stereotipeve gjinore në raportet gazetareske, kjo analizë synon të identifikojë narrativet e dëmshme në hapësirën online që synojnë viktimat e dhunës seksuale, me theks të veçantë në rastet kur vihet në pyetje pëlqimi i viktimave, qoftë duke mohuar në mënyrë të qartë kuptimin e saj, përmes rrethanave shtrënguese ose manipuluese ose përmes narrativeve që hedhin përgjegjësinë tek viktima.

Analiza mbuloi përmbajtje që, në vend që të informojnë dhe edukojnë, kontribuojnë në diskreditimin e viktimave dhe viktimizimin e tyre të dyfishtë, veçanërisht përmes narrativeve që vënë në dyshim pëlqimin ose relativizojnë përgjegjësinë e dhunuesit. Qëllimi përfundimtar i kësaj analize është të theksojë se si mediat kontribuojnë në formimin dhe përhapjen e narrativeve të dëmshme për dhunën seksuale, veçanërisht në hapësirën digjitale, në mënyrë që të propozojnë mënyra për raportim të përgjegjshëm dhe etik që do të respektojë dinjitetin e viktimave dhe do të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për këtë problem serioz.

Fokusi kryesor i dy rasteve studimore të paraqitura në këtë analizë ishte raportimi në media për përdhunimin, si forma më e rëndë e dhunës seksuale. Hulumtimi u krye duke përdorur analiza cilësore të raporteve gazetareske në lidhje me dy raste të përdhunimit, një në Maqedoninë e Veriut dhe një në Francë. Një rast i përdhunimit të një vajze të mitur në Veles, i cili mbuloi publikimin fillestar të lajmit në media, si dhe raportet gazetareske në lidhje me gjykimin që pasoi, si dhe një rast i përdhunimit të shumëfishtë të një gruaje të rritur në Francë, Giselle Pelico, e cila doli për të zbuluar publikisht rastin, me qëllim që të thyejë kulturën e heshtjes dhe të theksojë rëndësinë e pëlqimit në diskursin ligjor dhe social mbi dhunën me bazë gjinore. Raportet e analizuara të lajmeve në lidhje me dy rastet u publikuan gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Mostra që u analizua përbëhej nga 270 raporte gazetareske të publikuara në mediat online që raportuan për rastin në Maqedoninë e Veriut që është subjekt i kësaj analize dhe 1400 komente mbi botimet e raporteve gazetareske në mediat sociale,

përkatësisht në platformat Facebook, Instagram dhe X, si dhe 250 raporte gazetareske dhe 85 komente në lidhje me rastin në Francë. Gjatë kësaj, përmbajtja me bazë gjinore u analizua përmes disa aspekteve specifike:

- Identifikimi i dhunës seksuale
- Përdorimi i stereotipeve gjinore
- Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore
- Përdorimi i gjuhës sensacionaliste
- Promovimi i kulturës së dhunës me bazë gjinore
- Ushtrimi i rolit ligjor parandalues për rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën me bazë gjinore
- Lloji i burimeve të përdorura në raportet gazetareske
- Respektimi i standardeve gazetareske dhe etike gjatë raportimit
- Përfshirja e rishikimit kritik dhe kontekstit më të gjerë në raportet gazetareske
- Efekti i përhapjes së pikëpamjeve të shprehura në raportet gazetareske mbi ndërgjegjësimin e publikut.

Konteksti i analizës

Dhuna me bazë gjinore është një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut, me pasoja të thella për viktimat, familjet e tyre dhe shoqërinë në tërësi. Si formë e dhunës me bazë gjinore, përdhunimi është një nga format më të rënda dhe traumatike të shkeljes së integritetit fizik dhe dinjitetit të viktimës. Kjo lloj dhune pasqyron shpërndarjen e pabarabartë të pushtetit midis gjinive dhe normat shoqërore të rrënjosura thellë që mbështesin një kulturë të tolerancës ndaj dhunës.

Mënyra se si përcaktohet, njihet dhe trajtohet përdhunimi në kontekstin ligjor dhe shoqëror luan një rol kyç në reagimin e shoqërisë ndaj kësaj forme të dhunës seksuale. Në diskutimet bashkëkohore, çështja e pëlqimit është thelbësore për përcaktimin e përdhunimit, pasi mungesa e pëlqimit vullnetar, të informuar dhe të shprehur qartë është një tregues i drejtpërdrejtë i dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, përcaktimi i pëlqimit është një sfidë komplekse.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) njeh natyrën strukturore të dhunës ndaj grave si dhunë me bazë gjinore, duke pasur parasysh se dhuna ndaj grave është një nga mekanizmat kryesorë socialë me të cilët gratë detyrohen në një pozicion vartës ndaj burrave.[1] Konventa e Stambollit përcakton një standard me të cilin çdo akt i dhunës me bazë gjinore pa pëlqim vullnetar trajtohet si vepër penale, përfshirë detyrimin e personit tjetër të përfshihet në akte të natyrës seksuale me personin e tretë pa pëlqimin e tij. Kështu, pëlqimi duhet të jetë dhënë vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të një personi, i vlerësuar në kontekstin e rrethanave.

Ndërsa Konventa e Stambollit thekson mungesën e pëlqimit si një element kyç në përcaktimin e përdhunimit, megjithatë, për shembull, në shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian (BE), përafrimi i ligjeve kombëtare me këtë përkufizim mbetet një sfidë. Përkufizimi tradicional i përdhunimit në legjislacionin kombëtar të BE-së përqendrohet kryesisht në dhunën, kërcënimin ose paaftësinë e viktimës për të

1 Këshilli i Evropës. (2011). Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalim dhe Luftë kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës Familjare. Stamboll, 11.V.2011

rezistuar. Megjithatë, kjo qasje konsiderohet e papërshtatshme për shkak të njohurive të reja në lidhje me reagimet e viktimave, të tilla si "frika paralizuese" ose palëvizshmëria tonike, e cila është një reagim i zakonshëm i viktimave të përdhunimit dhe nuk përfshin rezistencë fizike.[2] Përkufizimet tradicionale gjithashtu nuk marrin parasysh situata të tilla si sulmi i papritur, marrëdhëniet e fuqisë ose dhuna e vazhdueshme në marrëdhëniet e dhunshme. Për më tepër, fajësimi i viktimave, siç është vlerësimi i veshjes, sjelljes ose moralit të tyre, historikisht është pjesë e kësaj qasjeje dhe shpesh mbështetet nga gjykatat.[3]

Një nga shembujt pozitivë është legjislacioni në Spanjë, ku u miratua një ligj i quajtur "po do të thotë po" (solo síes sí), i cili presupozon ekzistencën e pëlqimit të qartë, ndërsa vendet e tjera vazhdojnë të mbështeten në përkufizimet tradicionale që theksojnë praninë e dhunës, përkatësisht rezistencën fizike ose detyrimin.

Nga ana tjetër, në Francë, neni 222-22 i Kodit penal përcakton agresionin seksual si çdo akt seksual të kryer me dhunë, detyrim, kërcënim ose befasi, ku detyrimi mund të jetë fizik ose moral.[4] Ligji nuk përmend në mënyrë eksplicite mungesën e pëlqimit, por u reformua në vitin 2021 për të kategorizuar aktet e detyruara gojore-gjenitale dhe aktet penetruese me të mitur nën 15 vjeç si përdhunim. Përkundër mbështetjes publike dhe eksperte për reforma të mëtejshme, Franca kundërshton një përkufizim në nivel të BE-së për përdhunimin, duke argumentuar se "përkufizimi i përdhunimit i propozuar nga Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian është në kundërshtim me atë të Konventës së Stambollit, e cila përqendrohet më shumë në rrethanat e një akti të tillë."[5]

Në Maqedoninë e Veriut, Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje përcakton dhunën seksuale dhe përdhunimin si çdo akt me natyrë seksuale, me çdo pjesë trupore ose objekt, në trupin e një personi tjetër pa pëlqimin e tij/saj.[6] Ligji thotë se dhuna seksuale ekziston edhe kur një person tjetër pretendohet ose detyrohet të përfshihet në akte të natyrës seksuale me një

2 European Parliament. (2024). Definitions of rape in the legislation of EU Member States. In-depth analysis. https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2024/757618/EPRS_IDA(2024)757618_EN.pdf

3 Ibid.

4 Ibid.

5 Ibid.

6 Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje (Gazeta Zyrtare e RMV nr. 24/2021.

person të tretë pa pëlqimin e tyre, me anë të të cilit pëlqimi duhet të shprehet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit, i vlerësuar në kontekstin e rrethanave. Por ndryshimet në Kodin Penal, që synonin harmonizimin e përkufizimeve, u miratuan dy vjet më vonë, në vitin 2023, ku përkufizimi i përdhunimit u harmonizua me Konventën e Stambollit. Ndryshimet në nenin 186 të Kodit penal kriminalizuan përdhunimin dhe sulmin seksual, duke e vendosur fokusin në "vullnetin e shprehur qartë" të viktimës si element kyç për përcaktimin e pëlqimit. Për më tepër, dënimet për përdhunime dhe sulme seksuale janë më të ashpra nëse kryhen me forcë ose kërcënim, kundër një fëmije, nëse kanë rezultuar në lëndime të rënda trupore, vdekje ose pasoja të tjera të rënda, nëse kryhen nga më shumë persona ose në një mënyrë veçanërisht të ashpër dhe degraduese ose nga urrejtja. Këto ndryshime kanë kontribuar në forcimin e kuadrit ligjor duke njohur pëlqimin si një element kyç, i cili përmirëson mbrojtjen e viktimave dhe pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare.

Në raportin e vlerësimit për zbatimin e Konventës së Stambollit në Maqedoninë e Veriut, Komiteti GREVIO[7] vëren se normat e raportimit të përdhunimit dhe dhunës seksuale janë jashtëzakonisht të ulëta, si dhe numri i viktimave që kërkojnë kujdes mjekësor në qendrat e referimit, duke shprehur shqetësim serioz për dënimet penale pothuajse inekzistente për vepra të tilla.[8] Prandaj, GREVIO beson se nevojiten masa urgjente për të inkurajuar viktimat të raportojnë krimet dhe për nxjerrjen e autorëve para drejtësisë. Në këtë drejtim, media mund të luajë një rol kyç përmes rritjes së ndërgjegjësimit, zvogëlimit të stigmës sociale në lidhje me dhunën dhe promovimin e burimeve në dispozicion dhe mbështetjen për viktimat.

Përkufizimi problematik i pëlqimit është i lidhur ngushtë me qëndrimet shoqërore dhe paragjykimet ndaj viktimave. Ideja e "viktimës së përsosur" e cila duhet të tregojë rezistencë fizike, të shprehë një "jo" të qartë ose të sillet në një mënyrë të caktuar në mënyrë që të jetë e besueshme, është e infiltruar thellë, si në diskursin ligjor ashtu edhe në atë publik. Qëndrime të tilla e komplikojnë më tej luftën kundër

7 Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence), i cili është një organ i pavarur për monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit.

8 GREVIO. (2023). Baseline Evaluation Report North Macedonia. Në dispozicion në: https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/-/grevio-publishes-its-baseline-evaluation-report-on-north-macedonia?fbclid=IwY2xjawIBtSZleHRuA2FlbQIxMQABHVcp52cR1_KwInEaaUWySsz68JKxUqg-kyIzwpjgx9PicniBVDuXDLnE7A_aem_QiZXUvhGllYKuODa60WCzg

dhunës me bazë gjinore dhe nxisin një kulturë të tolerancës ndaj dhunës dhe normalizimit të saj.

Përkundër rëndësisë së rregullimit ligjor të formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, me rëndësi të veçantë është nevoja për të inkurajuar ndryshime shoqërore që do të dekonstruktojnë stereotipet gjinore për viktimat dhe do të avancojnë ndërgjegjësimin shoqëror për dhunën me bazë gjinore. Prandaj, përkufizimi i përdhunimit dhe koncepti i pëlqimit, megjithëse janë përkufizuar ligjërisht, nuk mund të kuptohen plotësisht pa marrë parasysh qëndrimet shoqërore që formojnë këto çështje. Sistemi ligjor është shpesh një pasqyrim i vlerave dhe normave të një shoqërie, kështu që mangësitë në përkufizimet ligjore të përdhunimit, megjithatë, dhe në zbatimin e tyre, shpesh shoqërohen me paragjykime dhe stereotipe shoqërore të rrënjosura thellë.

Në Maqedoninë e Veriut, si në shumë vende të tjera, përdhunimi trajtohet përmes një prizmi të paragjykimeve morale dhe kulturore, ku përgjegjësia për dhunën e kryer shpesh zhvendoset te vetë viktima. Në vend që fokusi të vendoset mbi (mos) veprën dhe shkelësin, shoqëria shpesh merret me çështje të tilla si pamja, veshja ose sjellja e viktimës. Një qasje e tillë mbështet kulturën e viktimizimit dhe zvogëlon gjasat që viktimat të raportojnë raste të dhunës me bazë gjinore.

Stereotipet sociale komplikojnë ndjeshëm kuptimin e pëlqimit, veçanërisht duke idealizuar "viktimën e përsosur", e cila pritet të jetë pasive, e pafajshme dhe e pafuqishme, e cila i reziston fizikisht dhunës. Viktimat që nuk i përgjigjen këtij stereotipi shpesh përballen me dyshime dhe akuza, duke çuar në viktimizim dytësor. Në raportin e OSBE-së për dhunën me bazë gjinore në Maqedoninë e Veriut thuhet se një numër i madh i viktimave shmangin raportimin e dhunës nga frika e stigmatizimit ose mungesës së besimit në institucione.[9] Këto stereotipe krijojnë një perceptim të shtrembëruar të asaj që përbën përdhunimin dhe pëlqimin, duke inkurajuar reagime publike që minimizojnë dhunën dhe inkurajojnë më tej heshtjen e viktimave.

Në shoqërinë maqedonase, tendenca për të toleruar vlerat tradicionale patriarkale që mbështesin idenë se pushteti dhe kontrolli janë atribute "normale" të sjelljes

9 OSBE. (2019). Mirëqenia dhe siguria e grave. Raporti i rezultateve të Maqedonisë së Veriut. Në dispozicion në https://www.osce.org/secretariat/419264

mashkullore është veçanërisht e dukshme. Qëndrime të tilla, të rrënjosura thellë në shoqëri, minojnë çdo përpjekje për të ndryshuar mënyrën e perceptimit të dhunës dhe pëlqimit me bazë gjinore. Përdhunimi shpesh trajtohet si një problem privat dhe jo si një fenomen shoqëror që kërkon një përgjigje institucionale dhe shoqërore.

Pavarësisht nga këto sfida, ka shembuj të ndërgjegjësimit dhe aktivizmit shoqëror që tregojnë një mundësi për ndryshim. Lëvizjet feministe dhe diskutimet publike rreth dhunës me bazë gjinore në vitet e fundit kanë nxjerrë në pah çështjen e pëlqimit si qendrore në luftën kundër këtij fenomeni negativ. Në këtë kontekst, mediat mund të luajë një rol të rëndësishëm në edukimin e publikut dhe dekonstruktimin e stereotipeve, për sa kohë që raportet gazetareske bazohen në standarde etike dhe profesionale.

Rastet që ishin objekt analize në këtë publikim tregojnë se perceptimet sociale mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në praktikën ligjore dhe raportimin në media. Në rastin e parë të përdhunimit të një vajze 15-vjeçare në Veles, fakti që ajo ishte e mitur e cila ishte viktimë e shantazhit dhe përdhunimit nga 13 persona nuk shkaktoi zemërim të mjaftueshëm publik për të kërkuar dënime më të larta dhe përgjegjësi më të rëndë nga institucionet, gjë që flet për një lloj normalizimi të këtyre krimeve, ku institucionet dhe shoqëria nuk i njohin plotësisht dimensionet e dhunës ndaj grupeve të rrezikuara.

Në kontekstin e pëlqimit, mënyra në të cilën shoqëria përcakton ose interpreton rëndësinë e saj është veçanërisht problematike. Në rastin e Gisele Pelico, pavetëdija dhe paaftësia e viktimës për të dhënë pëlqimin ishin faktorët kryesorë, por diskutimet publike gjithashtu dinin të minimizonin këtë aspekt, duke ngritur pyetjen nëse viktima kishte "vënë veten në rrezik", gjë që pasqyron perceptimin se përgjegjësia për shmangien e dhunës bie mbi viktimën dhe jo mbi autorin për të siguruar pëlqimin e qartë.

Mediat kanë fuqinë të formësojnë perceptimin publik të pëlqimit dhe përdhunimit, por raportimi i tyre shpesh pasqyron diskursin dhe paragjykimet mbizotëruese të shoqërisë rreth dhunës me bazë gjinore. Me narrativë sensacional dhe gjuhë që normalizon përgjegjësinë e viktimës, mediat ndikojnë në forcimin e stereotipeve të dëmshme gjinore dhe minimizojnë ashpërsinë e dhunës. Në këtë mënyrë, media kontribuon në ruajtjen e kulturës së tolerancës ndaj dhunës me bazë gjinore, duke nxitur më tej heshtjen dhe stigmatizimin.

Studim i rastit:

Përdhunimi dhe shfrytëzimi i një vajze 15-vjeçare në Maqedoninë e Veriut.

25 vjeçar nga Velesi S.D. në dhjetor 2021, nëpërmjet Instagramit, ka komunikuar me një vajzë të mitur 15-vjeçare, me të cilën ka bërë materiale pornografike në[10] takimin e parë, të cilat më tej i ka përdorur për ta detyruar vajzën të vijë në takime të tjera, duke kërcënuar se nëse nuk do të vinte, materialet me përmbajtje intime do të publikoheshin dhe shpërndaheshin në rrjetet sociale, duke dëmtuar kështu nderin dhe reputacionin e saj. Në këtë mënyrë, personi e detyroi vajzën në disa raste të shkonte në apartamente që ishin marrë me qira me qëllim, në disa lokacione në Veles, dhe përmes kërcënimeve dhe shantazheve u mundësoi njerëzve të tjerë të kryenin dhunë digjitale dhe dhunë me bazë gjinore. Që nga fundi i dhjetorit 2021 dhe gjatë vitit 2022, vajza ka qenë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore - veçanërisht përdhunimit, shfrytëzimit seksual[11] dhe pornografisë së fëmijëve. Grupi u zbulua krejt rastësisht, kur një artisti tatuazhesh iu grabit telefoni dhe u gjet edhe një video e fëmijës nga Velesi.

Gjykimi i 13 personave të akuzuar në këtë çështje filloi më 19 shtator 2023. Tre prej tyre akuzohen për “trafikim me fëmijë”, disa akuzohen për veprën penale të “sulmit seksual” ose “përdhunimit”, dhe një akuzohet për “prodhim dhe shpërndarje të pornografisë së fëmijëve”. Ata të gjithë janë të moshës nga 20 deri në 32 vjeç. Një nga të dyshuarit e rastit, në mbrojtjen e tij jep prova të rreme për pjesëmarrjen e tij,

10 Pornografia jokonsensuale, shpesh e referuar si pornografi hakmarrëse, është çdo filmim i paautorizuar (me një kamerë ose videokamerë) dhe/ose shkëmbim, si dhe kërcënime për të ndarë, të pamjeve në të cilat një person paraqitet lakuriq ose në një situatë me konotacion seksual, të gjitha me qëllim poshtërimin, turpërimin ose shantazhimin e tyre (Termi i dhunës me bazë gjinore i kryer nga (keq)përdorimi i teknologjisë, UNFPA)

11 Kur qëllimi është shantazhi, mund të flasim edhe për shantazh seksual (sextortion), qëllimi i të cilit është të zhvatë para nga një person ose t’i detyrojë të bëjnë diçka që nuk duan, siç është një akt seksual, nën kërcënimin se do të publikohen foto ose video nudo me konotacion seksual.(Fjalor dhuna me bazë gjinore e kryer me (keq)përdorim të teknologjisë, UNFPA)

për të cilat janë iniciuar procedura nga Prokuroria Themelore Publike dhe gjatë procedurës së hetimit përcaktohet se i dyshuari është ndihmuar nga avokati, pronari i hotelit dhe ndërmjetës.

Në vitin 2024, vendimi u miratua në Ditën Botërore të Fëmijëve dhe Ditën kushtuar parandalimit të abuzimit seksual të fëmijëve. Dënimi më i lartë për autorët që u shqiptua në Gjykatën Penale në Shkup është 5 vjet e 6 muaj burg, dhe më i ulëti është dënimi me kusht. Gjykata i shpalli fajtorë të gjithë 13 të rinjtë për abuzim seksual me një të mitur, incizimin e saj dhe shpërndarjen e incizimeve. “Kjo nuk është një betejë e burrave kundër grave, por një betejë e brezave të ardhshëm, “ tha gjykatësja Daniella Dimovska pas vendimit gjyqësor.

Narrativet mediatike për rastin e vajzës nga Velesi paraqiten përmes dy pozitave dominuese - narrativës ligjore dhe institucionale, në krahasim me aspektin social dhe kontekstin e rastit.

Disa raporte gazetareske ofruan analiza të hollësishme, duke u përqendruar në deklaratat e profesionistëve ligjorë, gjyqësorit dhe punonjësve socialë në kontekstin e mbrojtjes së viktimës së mitur dhe monitorimit etik të gjykimit. Kjo qasje kontribuoi në një shtrirje gjithëpërfshirëse të zhvillimeve duke kontekstualizuar rastin e plotë. [12] [13] [14]

Në një nga raportet për rastin në TV Sitel[15], u konsultuan ekspertë - psikologë për të theksuar nevojën për programe parandaluese sistematike, duke raportuar:

12 Me para deri te liria: Burri nga Velesi i cili është në gjyq për festa seksuale me një fëmijë të shantazhuar është liruar nga paraburgimi - Shkup1.mk

13 Burg për të 13 të pandehurit e “grupit të Velesit” për abuzim seksual me të mitur

14 Hetimi për abuzimin seksual të të miturës dhe material pornografik në Veles u zgjerua në 10 persona të tjerë

15 Pesë të dyshuar për shantazh ndaj një të miture, e joshën në rrjetet sociale dhe abuzuan seksualisht me të për vite me radhë | Televizioni Sitel

> Një ekip ekspertësh nga Qendra për Çështje Sociale nga Velesi bisedoi me vajzën dhe asaj tashmë i është ofruar mbështetje dhe ndihmë psikosociale nga ekspertë. Psikologët paralajmërojnë se autoritetet tani duhet të jenë shumë të kujdesshëm me viktimën. Ata thonë se është e nevojshme që shteti të prezantojë një program të mirë sistematik për të ndihmuar viktimat e tilla, por gjëja më e rëndësishme është t'u shpjegohen të rinjve rreziqet që fshihen në rrjetet sociale."

Në këtë mënyrë, mediat shtojnë kontekstin social në mënyrë që të krijojnë kujdes për viktimën.

Megjithatë, kjo mënyrë e raportimit nuk u vu re në shumicën e raporteve të lajmeve, të cilat ishin përqendruar kryesisht në "dramën" para dhe në sallën e gjyqit, duke transmetuar pamjet e të dyshuarve duke u përshëndetur në gjykatë nga një turmë e përkrahësve të zemëruar të të dyshuarve [16] [17]. Ndërkohë, media të tjera raportuan për rastin në një mënyrë që i jep përparësi vlerës tronditëse mbi diskursin e informativ[18] [19] [20]. Në këtë mënyrë, fokusi i raportimit mbetet sensacional, dhe jo informues dhe analitik.



-MONSTRUOZE, NJË VIT E KANË PËRDHUNUAR, RRAHUR DHE KEQTRAJTUAR!

-Pesë persona janë arrestuat për keqtrajtimin e një vajze 14 vjeçe

16 VIDEO: Në rastin e abuzimit seksual të një vajze 14-vjeçare, dhjetëra të dyshuar të tjerë – A1on.mk

17 Lot dhe zemërim në fillim të gjykimit ndaj 13 të rinjve nga Velesi, të akuzuar për abuzim seksual me të mitur – Radio Evropa e Lirë

18 KA PËRBINDËSHA MIDIS NESH: Katër veta në Veles përdhunuan një vajzë 14-vjeçare - Lider

19 Një ngjarje e tmerrshme në Veles – një vajzë 14-vjeçare e përdhunuar nga pesë persona


20 TMERRUESE, NJË VIT E KANË PËRDHUNUAR, RRAHUR DHE TORTURUAR! Pesë persona të ndaluar për ngacmimin e vajzës 14-vjeçare – PlusInfo.mk

-Është paraqitur kallëzim penal deri te Prokuroria Publike Themelore për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, për veprën penale "tregti me fëmijë" sipas nenit 418-g të Kodit penal – thonë nga MPB-ja

Për më tepër, viktimizimi sekondar ishte i pranishëm në raportet gazetareske[21], të cilat ekzistonin edhe në narrativin e proceseve gjyqësore që u raportuan nga mediat[22], ku kredibiliteti i fëmijës viktimë u vu në pikëpyetje ose vepra penale u formësua për t'u dukur më pak serioze[23]. Në disa raporte gazetareske, standardet e dyfishta ishin të dukshme në drejtim të mbrojtjes së autorëve nga përgjegjësia, në vend që të mbronin drejtësinë për viktimën:

> Nuk dihet se çfarë ka ndodhur saktësisht midis të dënuarve dhe viktimës, pasi arsyetimi i vendimeve gjyqësore ka qenë i mbyllur për publikun për mbrojtjen e viktimës, por avokatët e disa prej të pandehurve në mbrojtje të tyre kanë thënë publikisht se ajo ka pasur sjellje problematike në të kaluarën dhe sot, duke konsumuar drogë dhe alkool dhe se klientët e tyre janë kurban në këtë rast." [24]

Narrative të ngjashme u ndanë në raportet gazetareske që në titull i jepnin përparësi një deklarate nga nëna e një prej të pandehurve, duke mos ofruar një rishikim kritik të ngjarjes së përgjithshme [25].



21 Platforma për barazi gjinore: Është e pasigurt të ekzistosh si grua në një shtet që nuk vepron - MakPress

22 Gjykata me dënime të lehta u jep dritë jeshile dhunuesve- VidiVaka


23 Kjo përputhet me kritikën e Adrienne Rich (1980) për ligjin maskilist të institucionalizuar, ku sistemet - përfshirë mediat - mbrojnë në mënyrë aktive burrat e fuqishëm nga përgjegjësia, ndërkaq nuk angazhohen për drejtësi për të mbijetuarit.

24 33 vjet burg për 13 persona nga Velesi për përdhunimin e një të miture - Magazin

25 Nëna e një prej të akuzuarve për përdhunimin e një vajze 15-vjeçare tronditi Maqedoninë: A e kontrolluan prindërit e saj se ku ka shkuar, me kë është shoqëruar | Shilo Magazine

-Nëna e një prej të akuzuarve për përdhunimin e vajzës 15 vjeçe tronditi Maqedoninë: E kanë kontrolluar prindërit ku ka shkuar, me kë është shoqëruar

Titujt e tillë nuk e bëjnë aktin e dhunës një çështje qendrore, por ndikimin mbi jetën e të pandehurve. Në këtë mënyrë, media zhvendos fokusin nga dhuna me bazë gjinore si një vepër penale në tragjedinë personale të autorëve, duke thirrur në mënyrë suptile në empati. Një relativizim më i drejtpërdrejtë u vu re në komentet në mediat sociale, duke zhvendosur përgjegjësinë tek viktima dhe duke neglizhuar që ajo ishte zbutur[26], pa pëlqimin për t'u shfrytëzuar seksualisht për më shumë se një vit.



-Nuk e kanë përdhunuar, e kanë ngarkuar

-Që në 14 vjet njoftohen në instagram, ku janë prindërit kur u blejnë telefon
A shohin çfarë bëjnë fëmijët në telefon, pak kontroll. Keqardhje për vajzën e cila është keqtrajtuar, traumë jetësore


-Sa nëna krenare ka edhe pse e dinë se vajzat e tyre me 14 vjet kanë të dashur oooo epo pastaj kur plas turpi aj pedofili, aj çfarë jo nuk do të thuhet që nuk është për arsyetim

-Mund të ketë dashur ajo këtu nuk i dihet çfarë nuk ka Zoti na ruajt

26 Grooming në internet (ang. online grooming) është një formë e sjelljes grabitqare me synimin për të rënë në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë përmes rrjeteve sociale ose platformave të tjera digjitale, të gjitha me qëllim të dhunës seksuale. Nënshtrimi funksionon në mënyrë të tillë që shkelësi (ngacmuesi) krijon një lidhje emocionale të rreme me personin që ai synon dhe e mashtron atë me qëllim të kryerjes së abuzimit seksual, shfrytëzim seksual (për shembull, shfrytëzim seksual përmes prostitucionit të detyruar) ose trafikim me fëmijë. Në rastet e «zbutjes» në hapësirën online, pretadorët shpesh paraqiten si fëmijë ose të rinj, ndërsa ndonjëherë kur krijojnë marrëdhënie kërkojnë një takim sy më sy, gjë që hap mundësinë e shfrytëzimit seksual dhe dhunës seksuale dhe fizike në hapësirën offline. Fjalorth për dhunën me bazë gjinore të kryer nga (keq)përdorimi i teknologjisë UNFPA)

Ndërsa vetëm një media raporton deklaratën pas publikimit të vendimit gjyqësor të këshilltarit ligjor të viktimës[27], deklarata e përfaqësuesit të të dyshuarve, e cila përmban stigmatizim dhe etiketim, u nda nga shumica e mediave: “Do të apelojmë vendimin gjyqësor. Vendimi për të është marrë pa prova dhe bazohet vetëm në deklaratat e viktimës. Kërkoni dhe interesohuni për të kaluarën e saj dhe do të shihni se jo gjithçka është aq e përfaqësuar sa personaliteti i saj është këtu në gjykatë[28]. “

Pretendimi i transmetuar i avokatit ndaj autorëve përforcoi rrëfimet e akuzës së viktimës, të përfshira në komentet nën raportet gazetareske në mediat sociale.



-Por rinia, vajza të reja që në 13 vjet kanë grim një kilogram dhe duket sikur i ka 25 vjet dhe dalin me 25 vjeçar për bar etj. Dhe në vende pa lidhje sepse ata janë “fraerët” e tyre askush nuk është fajtor, tani paramendo pak a e kanë fajin këta fraerët e tyre që shkojnë me to ose e ka fajin edukimi familjar

-Djem nuk e di si mund ta quani vajze atë vajzë, më vjen keq për djemtë por kjo është, të gjithë e dimë se ajo e ka dashur gjithë këtë dhe e lejoni, mos shkruani komente të kota kur nuk e dini të vërtetën dhe vetëm bëni skroll nëpër portale ndërsa sido qoftë edhe ajo do ta hajë burgun, karma vërtet ekzistoka!


27 Ankesa në lidhje me vendimet gjyqësore për popullin e Velesit: Përdhunuesit e të miturës morën dënime me burg nën minimumin ligjor - Sllobodën peçat

28 33 vjet burg për 13 persona nga Velesi për përdhunimin e një të miture, vendim për një betejë të gjeneratave të ardhshme – Radio Evropa e Lirë

-sa janë fajtor djemtë aq është fajtore edhe ajo vetë që ka pritur jastëk të artë e ka ditur se është më shumë se 1 person çfarë më tepër.

-A DO TA PARAQESË NDONJËHERË KY SHTET PASQYRËN REALE PËR TË GJITHA NGJARJET E KËTILLA? PSE ASKUND NËPËR MEDIAT NUK SHKRUHEJ PËR ATË VAJZË SI VRAU NJERI DHE PËR ATË SE SI KA SHITUR VETEN ME VULLNETIN E SAJ NËPËR TË GJITHA QYTETET PËRRETH NË VETËM 14/15 VJET (sepse shteti apo shumë e lejoj këtë) TË GJITHË I DIMË FËMIJËT KUSH JANË DHE ÇFARË JANË DHE SE KANË MBETUR TE AJO 14 VJEÇARE TË PALARË QË SHITET PËR NJË SHISHE DHE NJË BAR TA PËRDHUNOJNË VETËM NJË MENDJELEHTË DO TA BESOJË KËTË!!! BURG PËR VIKTORIJA!!!

Shumica e raporteve gazetareske theksuan dënimin me burg prej 33 vjet për të pandehurit, por nuk iu referuan faktit se ata ishin 13 autorë[29], të cilët gjithashtu u dënuan me dënime minimale pa theksuar rrethanat lehtësuese, me çka demonstrohet pavetëdija për veprën penale dhe dhunës që vajza e mitur përjetoi.



29 Për PËRDHUNIMIN E NJË TË MITURE: Trembëdhjetë persona nga Velesi shkojnë pas grilave

-Vendim gjyqësor i Gjykatës penale: Burg për të gjithë 13 të akuzuarit nga "grupi i Velesit" për keqtrajtim seksual të një të mitur

-Të gjithë 13 pjesëtarët e grupit të Velesit të dënuar për keqtrajtim seksual të të miturës

-Burg për 13 të akuzuarit nga "grupi i Velesit" për keqtrajtim seksual të vajzës 14 vjeçare

-Mbi 30 vjet burg për 13 banorë të Velesit të cilët përdhunuan një të mitur

-33 vjet burg për 13 banorë të Velesit për përdhunimin e një të mitur, vendim gjyqësor për betejën e gjeneratave të ardhshme

-33 vjet burg për 13 banorë të Velesit për përdhunimin e një të mitur

Megjithatë, kishte edhe media që theksonin parregullsitë procedurale[30], butësinë në dënime[31] dhe dështimet sistematike në mbrojtjen e viktimave[32]. Me transmetimin e deklaratës së këshilltarit ligjor të viktimës, ata vunë në dyshim vendimin për lirimin e të pandehurit kryesor nga paraburgimi, duke theksuar se precedentët procedurialë sugjerojnë një rrezik të vazhdueshëm për viktimën[33]. Për më tepër, përcollën reagimin e Platformës për Barazi Gjinore, e cila, duke kritikuar vendimin e gjykatës, kërkoi dënime më të ashpra për krimet kundër vajzave dhe grave,[34] dhe analizuan se si dënimet e buta dërgojnë një mesazh më të gjerë për mosndëshkim për dhunën me bazë gjinore[35]. Raportimi nga disa prej mediave mbuloi gjithashtu mangësi më të thella strukturore në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.

30 Me një garanci prej 70000 euro, një 26-vjeçar nga Velesi i cili ishte në paraburgim ndërsa gjykohet për "trafikim me fëmijë" u la i lirë. | Shillo Magazin

31 Na duhen reforma sistematike dhe dënime më të ashpra për krimet kundër vajzave dhe grave - Trn.mk

32 Reagim i ashpër ndaj dënimeve nën minimumin për trafikimin dhe përdhunimin e fëmijëve: Është dërguar një mesazh se vepra penale nuk është serioze! – Skopje1

33 Me para deri te liria: Burri nga Velesi i cili është në gjyq për festa seksuale me një fëmijë të shantazhuar është liruar nga paraburgimi - Shkup1.mk

34 Platforma për barazi gjinore: Janë të nevojshme reformat sistematike dhe dënimet më të ashpra për krimet kundër vajzave dhe grave| Meta.mk

35 Gjykata me dënime të lehta u jep dritë jeshile dhunuesve- VidiVaka

Законот гарантира, но праксата потфрла во обезбедувањето поддршка на жртвата

Иако законот за кривична постапка во однос на судската постапка и постапката пред јавен обвинител вели дека сите професионалци инвалидирани треба да се грижат за здравјето, добросостојбата и да обезбедат поддршка на жртвата, сликата во реалноста е многу поразлична.

-Ligji garanton, por praktika dështon në sigurimin e mbështetjes së viktimës

-Edhe pse ligji për procedurë penale në lidhje me procedurën gjyqësore dhe procedurën para prokurorit publik thotë se të gjithë profesionistët të invaliduar duhet të kujdesen për shëndetin, mirëqenien dhe të sigurojnë mbështetje për viktimën, pasqyra në realitet është shumë më ndryshe.

Është e rëndësishme të theksohet se analiza e mediave sociale zbuloi gjithashtu një numër kritikash për rastin, korrupsionin në gjyqësor dhe mungesën e drejtësisë.

Срамота!!! И ова ли е држава бе ???
Ccccccc sram
A be severnaci vie uste ne znaefte kade ziveete prvo naucite kade ziveete posle ce mate drzava
So pari se se moze bez razlika kakvo zlostorno delo si napravil moreee treba vo zatvor da skapat ,toaa e ovaa nasa cudesna zemja
Ima li normalen vo sutstvovo
Sramotaa !!!
Ete a nashata drzava i nasheto sudstvo...
Bravo za sudstvoto, kacite im platite!!!!
Sramota
prodaena drzava posle mladinata si odela ni zakoni nisto zastrametese na decata vasi da mu se sluci takvo nesto ce ja zapalite drzavata dojde vreme da se udira po decata se e izlezeno od kontrola loso i zalno 🙏 😔 😡 namesto da se kazna najstrogo sho mozi tie gi pustaa na slobodaaa zastrameteseeeee

-Ja shteti dhe gjyqësori jonë...

-Bravo për gjyqësorin, rritni rrogat e tyre!!!

-Turp

shtet i shitur pastaj thoni të rinjtë ikin as ligje as asgjë

turpërohuni fëmijëve tuaj tu ndodhë diçka e këtillë do ta ndiznit gjithë shtetin erdhi koha të prekni fëmijët gjithçka ka dalë nga kontrolli keq dhe për keqardhje...në vend të dënohen me dënime më të repta i lëshuan në liri turpëroooooohuni

-Turp!!!! A është ky shtet???
Ccccc turp

-A bre severxhanë ju as që e dinit ku jetoni fillimisht
mësoni ku jetoni pastaj do të keni shtet

-Me para gjithçka është e mundur pa dallim çfarë vepër të keqe ke bërë moreee duhet të kalben në burg, ky është shteti jonë i çuditshëm

-A ka njeri normal në gjyqësor

- Turp!!

Ajo që mungonte në publikimet gazetareske ishte theksimi i dimensionit digjital të shfrytëzimit seksual. Në një kohë kur dhuna digjitale me bazë gjinore është e përhapur dhe synon veçanërisht të rinjtë, do të kishte qenë veçanërisht e rëndësishme të analizohej ai aspekt i rastit. [36] [37]

36 Dhuna me bazë gjinore po përhapet edhe në hapësirën digjitale: Lufta e heshtur e grave queer në Maqedoni - Meduza

37 “Jashtë ekranit: Zbulimi i dhunës gjinore digjitale përmes një vështrimi kritik” Rrjeti Stella 2024

Studim i rastit:

Përdhunimi i shumëfishtë i Gisele Pelico në Francë

Rasti i Gisele Pelico, gruaja që fshehurazi u drogua dhe u përdhunua nga burri i saj dhe më shumë burra në Francë nga viti 2011 deri në vitin 2020[38], u mbulua në mënyrë gjithëpërfshirëse në nivel global nga mediat në nivele të shumëfishta, për sa i përket rëndësisë së vendimit të saj për ta bërë gjyqin publik[39], guximit të saj[40] dhe ndikimit në shoqëri[41].

Në mediat maqedonase kishte 250 raporte gazetareske, shumica e të cilave u përsëritën në titujt kryesorë, siç është titulli "Macron: Faleminderit Giselle Pelico" (mbi 15 postime). Edhe pse kjo mund të interpretohet vetëm si përcjellje e deklaratës së presidentit francez Emmanuel Macron, ky lloj i raportimit megjithatë tregon rëndësinë e shprehjes së solidaritetit me viktimat nga udhëheqja shtetërore dhe kështu të dërgohet një mesazh i qartë i mbështetjes për publikun.

Shumica e mediave maqedonase transmetuan titujt kryesorë dhe raportet e mediave botërore, të cilat u përqendruan në pranimin e fajit nga përdhunuesit: "Unë jam një përdhunues si të gjithë të tjerët në këtë sallë gjyqi: burri nga Franca pranoi se drogoi gruan e tij dhe ftoi burra të tjerë për ta përdhunuar". Më e rëndësishmja, raportet gazetareske theksuan se përdhunuesit vijnë nga prejardhje të ndryshme, gjë që ndihmon për të larguar mitin se ato janë lehtësisht të dallueshme dhe se nuk mund të jenë pjesë e mjedisit të përditshëm të grave:

38 Pelicot rape trial: 'I never regretted my decision to go public,' says Gisèle Pelicot as husband and 50 others found guilty – as it happened | Gisèle Pelicot rape trial | The Guardian

39 Gisèle Pelicot has rewritten her story – and electrified women all over the world. But what about men? | Rebecca Solnit | The Guardian

40 Gisele Pelicot is a hero | Women's Rights | Al Jazeera

41 Married to a monster: How Gisele Pelicot went from victim to feminist hero | World News

> Policia mundi të identifikonte vetëm 50 të dyshuar nga 83 burra që shfaqen në videot e Dominic Pelicott. Ata janë të moshës nga 26 deri në 68 vjeç, ndër ta ka zjarrfikës, farmacistë, punëtorë dhe gazetarë. Shumë prej tyre kanë gra dhe fëmijë. Vetëm 15 prej tyre pranuan përdhunimin, ndërsa të tjerët pretenduan se kishin marrë pjesë në akte seksuale. Disa nga abuzuesit thanë se mendonin se gruaja po pretendonte se ishte në gjumë. "[42]

Raportet gazetareske u përqendruan në solidaritetin dhe guximin, por edhe kërkimin e drejtësisë së Gisele Pelico, duke raportuar: "Raportimi i saj shpëtoi jetën e një gruaje: heroina që dënoi burrin që drogoi gruan e tij dhe solli burra të panjohur për ta përdhunuar"[43], " Lufta e guximshme e Gisele Pelico: viktimë e një krimi të tmerrshëm, një simbol i rezistencës"[44], " Dënime më të ashpra për përdhunuesit e Gisele Pelico, drejtësi për të gjitha gratë në Francë"[45] dhe "Në Francë, tubime në mbështetje të Gisele Pelico dhe viktimave të përdhunimit"[46]. Titujt si "Giselle Pelico: Asnjëherë nuk u pendova që hoqa dorë nga e drejta e anonimitetit"[47] kontribuojnë në zbërthimin e kornizave të bazuara në turpin e viktimave dhe inkurajojnë një ndërprerje në kulturën e heshtjes dhe relativizimit që mundëson dhunën seksuale sistematike. Për më tepër, në raportet gazetareske u raportuan deklarata solidariteti nga grupe dhe organizata të ndryshme feministe.

Titujt shënojnë një senacionalizim të pjesshëm, siç është: "Horror në Francë: burri që drogoi gruan e tij që të përdhunohet nga 50 burra, u transportua urgjentisht në spital, sot duhej të dëshmonte para fëmijëve."

Në mediat sociale maqedonase, shumë nga reagimet u përqendruan në shprehjen aktive të pakënaqësisë ose mosinteresimit për këto tema, duke mos e lidhur këtë rast me raportet e përditshme të mediave për dhunën seksuale në vend.

42 Tubime në Francë në mbështetje të Gisele Pelico dhe viktimave të përdhunimit - Free Press

43 Raportimi i saj shpëtoi jetën e një gruaje: Heroina që dënoi burrin që drogoi gruan e tij dhe solli burra të panjohur për ta përdhunuar – Pres 24

44 Lufta e guximshme e Giselle Pelico: viktimë e një krimi të tmerrshëm, simbol i rezistencës - Trn.mk

45 Dënimet më të ashpra për përdhunuesit e Giselle Pelicot, drejtësi për të gjitha gratë në Francë - Slloboden Peçat

46 Në Francë, tubime në mbështetje të Gisele Pelico dhe viktimave të përdhunimit - MIA

47 Gisele Pelico: Asnjëherë nuk u pendova që hoqa dorë nga e drejta e anonimitetit | Kajgana

[redacted] Доволно слушаме за секакви трагедии секој ден и на вести на телевизија и на нивните сајтови. Ајде можеме нив да ги избегнеме, ама и овие сајтови како фемина ли треба и тоа да го пишуваат? Па дури и да знаеме за ваквите вести, не можеме да ја промениме реалноста, за жал. Можеме само стрес да добиеме. Некои сме со слабо срце... Реалноста ја знаеме, барем да ја олабавиме со поубави нешта, по позитивни вести...

Мислам дека не ви требаат ваков тип наслови и текстови... Вие сте сепак забавно-културен сајт. 💗

Sekoj si zema za pravo sve i svasta da objavuva...porano se znaese kakvi vesti treba da se objavuvaat ...svetot otide u kurac,a i nie so nego...treba celosno resetiranje..

Кој од нас Македонците го тоа интересира..или давате идеи за некои малоумни,како да дојдат до "лесни" пари..на кое ниво спаднавте и порталите и медиумите😡

GNASI NOVINÀRSKI ZAR OVAKVO NESTO SE OBJAVUVA SRAMOTA ISALA ZENITE DA SI GI IZNAJMITE ZA ZIMSKA SEZONA

Релативизирање:

Traumi od detstvoto.Poremeten um.
Shto majka pa taa go trpela psihopatot so godini?

-Mjaftueshëm dëgjuam për tragjedi të ndryshme çdo ditë edhe Në lajme edhe në televizion edhe në faqet e tyre.
Ato edhe mund t'i evitojmë po edhe këto faqet si femina duhet ta shkruajnë të njëjtën? Edhe sikur të dimë për lajme të tilla nuk mund ta ndryshojmë realitetin, për fat të keq. Mund të fitojmë vetëm stres. Disa jemi me zemër të dobët...Realitetin e dimë, të paktën ta lehtësojmë me gjëra më të bukura, me lajme pozitive...

-Mendoj se nuk ju duhen lloj i këtillë i titujve dhe teksteve...Ju megjithatë jeni një faqe argëtuese – kulturore.

-Secili merr të drejtën të publikojë çdo gjë...më parë dihej cilat lajme duhej të publikoheshin...bota shkoj në të sëmës, ne bashkë me të... na duhet një reset i plotë.

-Kush nga ne maqedonasit interesohet për këtë...Ose jepni ide për mendjelehtët, si të bëjnë para "të lehta"...në çfarë niveli keni rënë edhe portalet edhe mediat

-Gazetarë të ndyrë a publikohet diçka e këtillë turp, ishalla gratë tuaja i jepni me qira për sezonin dimëror.
Relativizim

-Trauma nga fëmijëria. Mëndje e shthurur. Pse e ka duruar psikopatin me vite?

Dhe në rastin e gruas franceze Gisele Pelico, pretendimi i rremë se autorët nuk e dinin se ajo ishte pa ndjenja[48], i përsëritur në media, tregon dështimin për të përcaktuar qartë pëlqimin në rastet e dhunës seksuale[49]. Me fjalë të tjera, media duhet të theksojë se pëlqimi ekziston vetëm kur jepet në mënyrë eksplicite dhe pa dykuptimësi.

48 Një nga përdhunuesit e Gisele pranoi: Po ta dija që ajo nuk ishte në dijeni, nuk do ta kisha bërë – Utrinski Vesnik

49 Një francez solli 50 burra për të përdhunuar gruan e tij, njëri prej tyre rrëfeu: Nuk u pajtua, më vjen keq - Toçka

Diskutim përfundimtar

Të dy rastet e përdhunimit të grave tregojnë se shoqëria e ka të vështirë të pranojë se dhuna seksuale është një problem sistematik, dhe jo vetëm një tragjedi individuale ose një rast i izoluar. Mediat duhet t'i kishin portretizuar këto raste përmes një diskutimi më të gjerë mbi relativizimin e përdhunimit, (mos)pëlqimin e viktimave dhe përgjegjësinë ligjore, duke siguruar që të përdhunuarit jo vetëm që do të "dëgjoheshin" (në rastin e vajzës nga Velesi), por edhe se ngjarje të tilla do të çonin në ndryshime reale.

Në rastet e vajzës 15-vjeçare nga Velesi, e cila u shfrytëzua, u nënshtrua dhe u përdhunua nga disa burra, dhe të gruas franceze Gisele Pelico, e cila u drogua nga burri i saj dhe gjithashtu u përdhunua nga disa autorë, një qasje tjetër vërehet në raportimin e mediave. Ndërsa në rastin e Pelikos, ku shumica e raporteve u morën nga mediat e huaja, ka raportim më të përshtatshëm dhe më të ndjeshëm ndaj gjinisë, në rastin e vajzës nga Velesi ka shumë hapësirë për përmirësim në mënyrën e raportimit të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht ndaj të miturve. Në rrjetet sociale, për të dy rastet, mbizotëruan komentet negative dhe të dënueshme ndaj të dy grave, të shoqëruara me relativizimin e përdhunimit dhe mos dhënien e pëlqimit nga viktimat. Megjithëse të dy viktimat ndryshojnë në moshë, vendndodhje dhe rrethana, stigmatizimi i dy grave përmes komenteve në raportet gazetareske në mediat sociale jo vetëm që pasqyron por gjithashtu formon në mënyrë aktive reagimet shoqërore ndaj dhunës seksuale.

Në rastin e vajzës së përdhunuar nga Velesi, përmes raportimit sensacionalist, theksimit selektiv të sjelljes së viktimave dhe privilegjimit të zërit të abuzuesve, raportet e mediave kontribuuan në normalizimin e dhunës seksuale në publik, duke minuar besueshmërinë e viktimave dhe mosndëshkimin sistematik. Kështu ruhet një kulturë përdhunimi dhe nxiten hierarkitë gjinore të kredibilitetit në të cilat disa konsiderohen "të besueshëm" ose "të denjë për drejtësi" nga të tjerët. Përveç kësaj, raportimi sensacionalist është në kundërshtim me përgjegjësinë etike të mediave, të parashikuar nga neni 8 i Kodit të gazetarëve, i cili ndalon sensacionalizmin në raportimin e procedurave gjyqësore dhe tragjedive familjare. Disa raporte

gazetareske kontribuuan që viktima të mohohej ose të fajësohej për abuzimin e saj. Gjuha e dyshimit e përdorur në raportimin e rastit kontribuoi në forcimin e besimeve të vendosura se viktima zakonisht është fajtore dhe ajo që është më e tmerrshme legjitimoi përdhunimin. Prandaj, komentet në mediat sociale përmbanin akuza, spekulime dhe arsyetime morale në lidhje me veprimet e viktimës së përdhunimit, në vend që të përqendroheshin në krimet e kryera kundër saj. Dhe kur komentet përforcojnë paragjykimet e dëmshme, të tilla si "Ku ishin prindërit e saj?" ose "Si duken vajzat e sotme?", nuk kontrollohen nga mediat, krijohet një precedent i rrezikshëm që justifikon dhunën seksuale. Prandaj, mund të thuhet se narrativet mediatike ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si do të diskutohet, legjitimohet ose refuzohet dhuna seksuale.

Analiza e të dy rasteve tregon nevojën urgjente për të kaluar nga raportimi reaktiv i bazuar në spektakël në gazetarinë e drejtuar nga viktimat dhe për raportim të thelluar që nxjerr në pah dështimet sistematike dhe jo rastet e izoluara "tronditëse". Pa një ndryshim të tillë, media do të vazhdojë të jetë bashkëfajtore në forcimin e normave shoqërore që kontribuojnë në dyshimin e viktimave në vend që të kërkojnë ndëshkimin e autorëve. Por nëse përqendrohen në përgjegjësinë për dhunën me bazë gjinore, si dhe sensibilizimin me viktimat e moshave dhe kategorive sociale të ndryshme, mediat mund të shërbejë si mekanizma të drejtësisë dhe ndërgjegjësimit, dhe jo si një vend për relativizim dhe ri-traumatizim.

Shënime përfundimtare

Analiza e raportimit mediatik për dy rastet e dhunës seksuale sugjeron nevojën për një qasje më etike dhe gjithëpërfshirëse gazetareske. Prandaj, është e nevojshme të merren parasysh rekomandimet e mëposhtme për rritjen e raportimit gazetaresk të rasteve të dhunës seksuale:

- Mediat gjatë raportimit duhet të shmangin inkuadrimin e rasteve të dhunës seksuale rreth veprimeve të viktimave, emocioneve të tyre ose besueshmërisë së tyre. Në vend të kësaj, raportimi duhet të theksojë përgjegjësinë e kryerësit, përkufizimet ligjore të (mos)dhënies së pëlqimit të viktimave dhe dështimet sistematike që lejojnë që të ndodhin vepra të tilla penale. Një ndryshim i tillë do të kontribuojë në parandalimin ose zvogëlimin e narrativave të fajësimit të viktimave dhe relativizimit të dhunës seksuale në diskursin publik.
- Mediat raportuese duhet të kenë një qasje të përqendruar në viktima që i jep përparësi saktësisë faktike, analizës sistematike dhe avokimit për mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore.
- Media gjatë raportimit duhet të theksojë interpretimet e qarta ligjore të dhënies së pëlqimit të viktimës në rast të përdhunimit, në mënyrë që të eliminohet paqartësia rreth dhunës seksuale, por edhe të kryhet ndikim mbi sistemet ligjore për të miratuar përkufizime më të forta për një pëlqim të tillë.
- Titujt sensacionalistë kontribuojnë për një spektakël publik në vend të një diskutimi të informuar. Për të parandaluar keqinterpretimet dhe misinformatat, mediat duhet t'i përmbahen kritereve etike për raportimin gazetaresk dhe të përdorin gjuhë të ndjeshme ndaj gjinisë. Kjo do të ndihmonte në edukimin e vazhdueshëm të gazetarëve për raportimin e rasteve që përfshijnë dhunën me bazë gjinore dhe krijimin e burimeve të reja dhe konsultimin e burimeve ekzistuese.
- Mediat nuk duhet t'i portretizojnë viktimat në mënyrë ofenduese dhe duhet të marrin parasysh dinjitetin dhe të drejtën e tyre për qasje në drejtësi.

- Platformat sociale të mediave kontribuojnë në legjitimimin e narrativeve të dhunuesve. Kjo është arsyeja pse media duhet të monitorojë dhe rregullojë në mënyrë proaktive komentet në raportet gazetareske për të parandaluar përhapjen e urrejtjes ndaj grave dhe mohimit të përdhunimit. Për më tepër, institucionet duhet t'i mbajnë mediat përgjegjëse për mundësimin e përhapjes së narrativeve të gabuara në hapësirën digjitale.
- Mediat, përmes raportimit gazetaresk, duhet të rrisin ndërgjegjësimin e publikut dhe të edukojnë audiencën për pasojat e relativizimit të dhunës seksuale.

Институт за комуникациски студии

НЕ ВЕРУВАЈ ПРОВЕРУВАЈ! #користифакти

www.iks.edu.mk
info@iks.edu.mk

British Embassy Skopje

UK International Development
Partnership | Progress | Prosperity

Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit “Përdorimi i gazetarisë së bazuar në fakte për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për luftë kundër dezinformatave në hapësirën mediatike në Maqedoninë e Veriut” financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë çdo herë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.

Институт за
комуникациски
студии

НЕ ВЕРУВАЈ
ПРОВЕРУВАЈ!
#користифакти